



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 11.3.2025

Nr: 255

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

**KORRIGJIMIN E GABIMEVE MATERIALE TË ADRESËS SË DEKLARUAR NË
PLATFORMËN ELEKTRONIKE TË REGJISTRIMIT (PER) TË DISA ZGJEDHËSVE
NGA JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe pika 2, nenit 24, pika 1, nenit 25, pikat 6 e 7, dhe nenit 99 e vijues të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 120 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 10, datë 23.10.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, si dhe vendimit nr. 11, datë 1.11.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Korrigjimin e gabimit material të adresës së disa zgjedhësve nga jashtë vendit, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 11.3.2025 Nr: 255
Ora: 10:00



“Për korrigjimin e gabimeve materiale të adresës së deklaruar në platformën elektronike të regjistrimit (PER) të disa zgjedhësve nga jashtë vendit”